



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 281/7 Prot.

Tiranë, më 09.06. 2023

**V E N D I M**

**Nr. 83, datë 09 . 06. 2023**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 26 regj, datë 16.02.2023, të paraqitur nga ankuesi A.P , kundër Bashkisë Lushnje, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “*denoncimit në media dhe prokurori, të veprimeve abuzive*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi A.P deklaron se, që prej vitit 2006 familja e tij përfiton nga Bashkia Lushnje nën statusin e ish pronarit, një ambient me vendndodhje pranë Muzeut Historik Lushnje. Në këtë ambient familja e tij ka investuar së bashku me një ish pronar tjetër, i cili zotëron 1/5 e sipërfaqes. Ankuesi shpjegon se, babai i tij hyri në marrëdhënie juridike me Bashkinë Lushnje. Mbas 5 vitesh, në pjesën ku babai i tij kishte investuar ndan në mënyrë paqësore ambientin me vëllain e vet, të cilët ndajnë edhe detyrimet ndaj bashkisë. Në janar 2021, një problem shëndetësor detyron xhaxhain e tij të ndërprerë marrëdhënien me bashkinë. Të dy së bashku i drejtohen bashkisë që të zgjidhë detyrimet kundrejt xhaxhait dhe ti kalojë si dikur, i gjithë ambienti por edhe detyrimet, babait të ankuesit.

Pikërisht, në këtë moment sipas ankuesit ka nisur kalvari i poshtërimeve dhe ofendimeve. Familjes së tij, jo vetëm që nuk iu dha pjesa e xhaxhait, por bashkia ka lidhur kontrate me një tjetër person, i cili është person shumë i afërt me ish kryetarin e bashkisë Fatos Tushe dhe nuk i rinovojnë edhe gjysmën tjetër që babai i ankuesit dispononte. Investuesit tjetër i cili zotëron 1/5 e sipërfaqes bashkia ia ka rinovuar kontratën dhe vazhdon sërish t’ia rinovojë.

Duke u gjendur në një situatë të tillë, ankuesi shpjegon se i është drejtuar emisionit Fiks Fare dhe Prokurorisë, për këtë abuzim skandaloz dhe shkatërrimin ekonomik të familjes së tij.

Ankuesi shpjegon se është i punësuar që prej vitit 2007 në institucionin e teatrit “Vace Zela”, në varësi të Bashkisë Lushnje. Ai pretendon se, Bashkia Lushnje, e ndodhur përballë kërkesave legjitime për vazhdimin e punës që familja e tij kishte ngritur në këtë ambient, ka vendosur që, fiks brenda një periudhe 2 mujore dhe me arsye të palegjituara të ndërpresë marrëdhënien e e

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

punës me pretendimin për mosrespektim të orarit zyrtar. Ankuesi thekson se jo vetëm që ka qenë në detyrë, por edhe me korrektësinë më të madhe dhe se është i vetmi me diplomë dhe me mesataren 9 në këtë institucion.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri rivendosjen në vend të të drejtës së që i është shkelur, duke u rikthyer në vendin e punës.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: **“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”**

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: **“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,** ndërsa në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, gërma “c”, të po këtij ligji, parashikohet: **“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”**

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon

ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Sipas nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

*Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr.26 datë 16.02.2023, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Me anë të e-mailit datë 09.03.2023, ankuesit i’u kërkua plotësimi i ankesës, veçanërisht në drejtim të përcaktimit të qartë të shkakut të pretenduar të diskriminimit të kërkuar në kuadër të “çdo shkakut tjetër”. Ankuesi saktësoi shkakun e diskriminimit dhe dorëzoi dokumentacionin plotësues nëpërmjet shkresës nr.281/1 prot datë 13.03.2023.*

*Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:*

1. Me shkresën nr.281/2 prot., datë 20.03.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Lushnje, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është drejtuar ankesa.
2. Me shkresën nr. 2490/1 prot., datë 29.03.2023<sup>2</sup>, Bashkia Lushnje depozitoi pranë Komisionerit parashtrimet e saj në lidhje me ankesën dhe dokumentacionin shoqëruës.
3. Nëpërmjet e-mailit të datës 04.04.2023, parashtrimet dhe aktet e dërguara nga bashkia Lushnje i’u komunikuan ankuesit.
4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.” për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri, njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike në datën 31.05.2023.
5. Nëpërmjet e-mailit të datës 27.05.2023, ankuesi paraqiti një kërkesë me shkrim nëpërmjet të cilës deklaroi se heq dorë dhe tërhiqet nga çështja objekt shqyrtimi.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

---

<sup>2</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr.281/3 prot., datë 03.04.2023.

Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 94 “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë. ....3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesi në datën 27.05.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 26 regj, datë 16.02.2023, të paraqitur nga ankuesi A.P , kundër Bashkisë Lushnje, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a” dhe pika 2, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 94, pikat 1 dhe 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.26 Regjistri, datë 16.02.2023, paraqitur nga z.A.P kundër Bashkisë Lushnje, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Çdo shkak tjetër/“denoncimit në media dhe prokurori, të veprimeve abuzive”  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Tërheqje nga ankesa.